



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 249/9 Prot.

Tiranë, më 30.06.2018

V E N D I M

Nr. 71, Datë 30.06.2018

PËR

AUDITIMI I USHTRUAR NË BASHKINË LEZHË ME OBJEKT “AUDITIM RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”, PËR PERIUDHËN 01.01.2016 – 31.12.2017

Nga auditimi i rregullshmërisë financiare të ushtruar në Bashkinë Lezhë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale (të rëndësishme), por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar. Fusha kryesore të cilat janë konstatuar gabime është ajo e zhvillimit të procedurave të prokurimit, zbatimit të kontratave të punimeve, zbatimi i kontratave për menaxhimin e asetëve, shpenzimet operative si dhe mosrealizimin e të ardhurave vendore.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Rregullshmërisë financiare të ushtruar në Bashkinë Lezhë, sipas programit nr. 249/1 prot, datë 05.03.2018 dhe shtesës nr. 249/2, datë 20.04.2018 për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Menaxhimi Financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Bashkinë Lezhë nuk ka funksionuar si duhet, duke evidentuar këto mangësi:

a-Mungesa e rregullores së funksionit të Bashkisë Lezhë, mbas reformës territoriale, në përcaktimin e detyrave konkrete për çdo drejtori/ sektor, agjenci dhe punonjës në veçanti, ka bërë që shumë drejtori ti shmangen përgjegjësi të detyrave funksionale për të cilat janë krijuar.

b-Krijimi në mënyrë të paargumentuar i drejtorive, sektorëve dhe agjencive në mënyrë jo të studiuar, duke rritur në mënyrë jo efektive numrin e punonjësve dhe fryrë padrejtësisht organikën e Bashkisë Lezhë, veprime të cilat kanë çuar në vënien në vështirësi financiare të bashkisë në kryerjen e pagesave për pagat, kjo si për mungesë të mos realizimit të të ardhurave por dhe fryrjes në mënyrë të paargumentuar të organikës, ku në fund të vitit 2017 janë 993 punonjës.

c-Në mbyllje të aktivitetit vjetor të Bashkisë Lezhë, hartimi i deklaratës të cilësisë të sistemit të kontrollit të brendshëm, raportit vjetor për funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorit të vetëvlerësimit të komponentëve të MFK janë të mangëta dhe nuk pasqyrojnë me vërtetësi realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/2, faqet 36-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me drejtues dhe specialistë, dhe me një program të mirë përcaktuar pune, për vlerësimin e situatës aktuale, përfshi dhe njësitë administrative dhe mbi bazën e konkluzioneve të përgatitjes strategjike vjetore dhe atë afatmesme të bashkisë, me qëllim përcaktimin sa më real të objektivave që duhet të arrijë Bashkia Lezhë, si dhe planet periodike të veprimit për përmbushjen e objektivave.

1.2. Rekomandimi: Të merren masa për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues të MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin e një plan-veprimi konkret, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së.

Të merren masa për caktimin e koordinatorit të riskut për organizimin e punës për identifikimin dhe menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik.

1.3. Rekomandimi: Të hartohet rregullore e re e funksionimit të gjithë sektorëve të Bashkisë Lezhë, ku të jenë mirpërcaktuar detyrat funksionale për çdo drejtori/ sektor dhe punonjës në veçanti për të evidentuar performancë e tyre dhe përshtatur riorganizimit të ri pushtetit vendor, si rezultat i reformës administrative të kryer në vitin 2015.

Në këtë kuadër inspektorët e taksave në njësitë administrative të kalojnë në përbërje të Drejtorisë të ardhurave të bashkisë dhe vartësi dyfishë Drejtori i të ardhurave/Administratorit të Njësisë Administrative.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në analizat e kryera për ecurinë e realizimit të shpenzimeve 6/mujore e vjetore në raport me planin fillestarë vjetor, nuk janë analizuar detyrimet ndaj të tretëve dhe nuk janë marrë masa për shlyerjen me përparësi të detyrimeve të prapambetura që kanë tendencë në rritje. Sipas të dhënave të pasqyruar në bilancin e vitit 2015 (çelur në vitin 2016), detyrimet ndaj të tretëve janë **446,279 mijë lekë**, ndërsa në fund vitit 2017 janë **680,345 mijë lekë**, ose janë rritur me 52% (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/3, faqet 45-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lezhë, të ngrijë një grup pune me specialistë me përvojë nga të gjithë sektorët për të marrë në analizë detyrimet kreditore dhe në fazën e përgatitjes së PBA dhe buxhetit vjetor 2019, të planifikojë fondet për mbulimin e detyrimeve ndaj të tretëve me qëllim përmirësimin e performancë në planifikimin.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në vlerësim e efektivitetit të reformës administrative territoriale mbi dinamikën e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave midis periudhave para dhe pas reformës administrative, konstatohet se kemi rritje të tyre. Kështu në fund të vitit 2017, krahasimisht me 6/mujorin e parë të vitit 2015, numri i të punësuarve është rritur me 277 veta, e cila ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore në vlerën 114,192 mijë lekë dhe të shpenzimeve operative për vlerën prej 486,338 mijë lekë .

Në këtë Bashki reforma territoriale nuk ka dhënë impaktin e dëshiruar, pasi ish komunat janë tej mbushur me punonjës në organikë dhe në Bashki ka shumë specialistë që kryejnë funksione paralele, ku vetëm njësia Shëngjin ka mbi 40 punonjës, Policia Bashkiake 31 punonjës, IMTV 17 punonjës dhe mjaft agjenci shërbimi të ngritura pa kritere dhe pa u studiuar nevojat për to (*Trajtuar më hollësisht në pikë III/3, faqet faqen 45-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lezhë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të kenë finalizuar procesin e analizës funksionale të veprimtarisë së institucionit dhe të kenë përcaktuar pozicionet e punës për çdo njësi administrative/ drejtori/ sektor dhe agjenci, duke pasur në konsideratë numrin e punonjësve para reformës territoriale (*Bashki dhe ish komuna, pa përfshirë transferimet nga grandit specifik*), të propozojë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, ndryshimet në strukturën organike të Bashkisë Lezhë.

Struktura të shoqërohet me një relacion shpjegues, si dhe me përshkrimet e punës, të miratuara në përputhje me ligjin, duke i emërtuar njësitë përbërëse të saj, si drejtori të përgjithshme, drejtori/ sektorë apo agjenci, në varësi të funksionimit të tyre, duke mbajtur parasysh aktet nënligjor që rregullon pagat në shërbimin civil.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në bilancin e Bashkisë Lezhë janë mbartur detyrime ndaj palëve të treta nga ish- komunat (6/mujorit parë të vitit 2015), të pa mbështetur me fatura, gjithsej për 14 raste në vlerë 6,252,817 lekë, konkretisht: Ish- Komuna Zejmen në 6 raste në vlerë 4,711,347 lekë, Ish- Komuna Shëngjin në 2 raste në vlerë 13,366 lekë, ish -Komuna Balldren në 2 raste në vlerë 717,572 lekë, Ish- Komuna Dajç në 2 raste në vlerë 722,914 lekë, ish- Komuna Kolsh në 2 raste në vlerë 87,618 lekë. Këto detyrime janë pasqyruar edhe në bilancet vijuese të viteve 2015-2016 dhe 2017, si efekt i mangësive të kryerjes së reformës administrative në kundërshtim me VKM nr. nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/3, faqet 53-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike (sektori i Kontabilitetit), të marrë masa për shkarkimin nga kontabiliteti të detyrimeve në vlerën 6,252,817 lekë që ju përkasin 14 rasteve të trashëguar nga ish -komunat (para reformës administrative) dhe të pa mbështetura fatura .

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në likuidimet e kryera në favor të firmës së pastrimit për vitin 2017, nuk është mbajtur ditari i punimeve për çdo ditë dhe përmbledhësja e punimeve sipas proceseve dhe operacioneve të punës për të rakorduar zërat e punës të situacioneve mujore, veprime në kundërshtim me nenin 5, të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” dhe kontratave nr. 7122, datë 27.9.2017; nr. 10078/4, datë 29.03.2017 dhe nr. 9022/2, datë 17.03.2017, të cila nuk argumentojnë vlerën e situacioneve të likuiduara (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/3, faqet 53-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për përcaktimin e detyrave të qarta për supervizorët e pastrimit, gjelbërimit dhe dekorit, duke përcaktuar të gjithë dokumentacionin ditorë që duhet të plotësojnë për efekt rakordimi me të dhënat e situacioneve mujore që paraqesin kontraktorët.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (Sektori i ALUIZNI-t) të Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me pikën 5, të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, dhe pikën 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen*, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar nuk ka bërë të mundur arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet që legalizohen.

Kështu për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017, sipas listave të vënë në dispozicion nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **628 persona me vlerë 20,632,717 lekë**, e ardhur e munguar në buxheti e Bashkisë Lezhë (*Trajtuar më hollësisht në pikë III/6, faqet 127-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (Sektori e ALUIZNI-t), në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të ALUZNI-t Lezhë dhe ZVRPP Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës **20,632,717 lekë ndaj 628 personave**, të pajisur me leje legalizimi sipas listave që disponon në sektorin e ALUIZNI-t, Bashkia Lezhë, sipas pasqyrës aneks 6/1 bashkëlidhur Raport Auditimit.

Brenda datës 31.10.2018

7. Gjetje nga auditimi. Në auditimin e kryer për administrimin e aseteve Bashkia Lezhë, u konstatua se ky proces nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e nenin 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pika 26 dhe 27; të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, për realizimin e të ardhurave nga dhënia me qira e ndërtesave të zaptuara me sipërfaqe gjithsej 10028 m². (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të marrë masa për krijimin e një strukture funksionale të menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për inventarizimin, evidentimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP Lezhë, krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Lezhë, për vënien në efikasitet të ndërtesave të zaptuara nga të tretë me sipërfaqe gjithsej 10028 m², për plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e tyre .

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në ekonominë Pyjore të Bashkisë Lezhë, kryejnë aktivitetet për shfrytëzim karriere 8 subjekte pa kontratë, të cilët kanë në përdorim 188.67 ha sipërfaqe pyjore/kullosore të shfrytëzueshme.

Për këto sipërfaqe nga Agjencia e Pyjeve, nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”; pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen

dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke i hequr nga fondi pyjorë dhe kullorë, si dhe t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në lidhjen e kontratave për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore prej 188.67 ha.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Zejmen sot Njësia Administrative Zejmen Bashkia Lezhë, me Vendime të Këshillit të Komunës për vitet 2010, 2011 dhe 2013, është vendosur dhënia në përdorim nga fondit pyjorë dhe kullorë e sipërfaqes prej 110.677 ha për 61 persona. Për këto sipërfaqe nuk janë lidhur kontrata qiraje me qëllim sigurimin e të ardhurave për Bashkinë, në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar; ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”; ligjit nr. 10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve METN”; ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për gjuetinë”; VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” dhe VKM nr 391, datë 21.6.2006, të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Agjencia e Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, të marrë masa dhe të bëjë evidentimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullorë që shfrytëzojnë persona privat, duke bërë bllokimin e veprimtarisë së tyre deri në lidhjen e kontratave për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore prej 110.677 ha dhe përlllogaritjen e detyrimeve nga momenti i shfrytëzimit, sipas pasqyrës Aneks 7/2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dosjeve të kontratave për dhënien me qira të hapësirës së plazhit me sipërfaqe 68956 m², u konstatuan se: Bashkia Lezhë nuk ka marrë konfirmimin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Agjencia Kombëtare e Turizmit), nëse hapësira e plazhit të kërkuar është objekt i ndonjë kërkese në shqyrtim apo kontrate në kuadër të ligjit nr. 55/2015, datë 28.05.2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë".

Gjithashtu në dosjet e kontratave mungon dokumentacioni tekniko-ligjorë si: plani i biznesit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë parashikimin e vlerës së investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve, dokumentacion për të vërtetuar eksperiencë të mëparshme pozitive në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, vërtetim nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, harta e hapësirës së plazhit të dhënë me qira, procesverbal i marrjes në dorëzim të hapësirës së plazhit, sipas kontratës, veprime në kundërshtim me pikat 1, 2 e nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, datë 27.07.2015 "Për Turizmin" dhe pikat 3, 4 e nenit 4, pika 3, 5 e nenit 6 dhe pika 3 e nenit 9, të VKM nr. 369, datë 18.5.2016 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë brenda një afati 3 mujor, të marrë masa për konfirmon në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (Agjencia Kombëtare e Turizmit), nëse hapësira e plazhit të kërkuar nga subjektet private është objekt i ndonjë kërkesë në shqyrtim apo kontrate, në kuadër të ligjit nr. 55/2015, datë 28.05.2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë".

Plotësimin e dosjeve me dokumentacion tekniko-ligjorë, të subjekteve që shfrytëzojnë hapësirat e plazhi (me qira), dhe në rast mos plotësimi ose mos kryerje të pagesave të qirasë, të kërkohej prishja e kontratave.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të kolaudimit të investimit mbi ndërtimin e ujësjellësit, fshati Troshan, Bashkia Lezhë, u konstatua se ngritja e grupit të kolaudimit është bërë me 2 (dy) muaj me vonesë, në kundërshtim me nenin 12 ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/4.1, faqet 110-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të marrë masa që në vazhdimësi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, nga data e deklaramentit të përfundimit të punimeve nga zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve, brenda 30 ditëve të emërojë kolaudatorin apo grupin e kolaudimit.

Vazhdimisht

12. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e aktivitetit të Policisë Bashkiake për periudhën e viteve 2016 - 2017, konstatohet se numri i punonjësve të Policisë Bashkiake është në kundërshtim me VKB nr. 296, datë 4.7.2016 "Për strukturën e Bashkisë Lezhë" dhe VKM nr. 313, datë 01.07.2002 "Për caktimin e strukturës, numrit të punonjësve dhe të shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë", pasi janë 7 policë mbi organikë, duke rënduar fondin e pagave të Bashkisë Lezhë për vlerën 588,000 lekë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/5.2, faqen 123-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë, Drejtorja e Burimeve Njerëzore në kuadrin e studimit për ripërcaktimin e strukturës dhe organikave të marrin masa për reduktimin e numrit të inspektorëve të Policisë Bashkiake bazuar në ngarkesën dhe zënien me punë të tyre, në zbatim të VKB nr. 296, datë 4.7.2016 "Për strukturën e Bashkisë Lezhë" dhe VKM nr. 313, datë 01.07.2002 "Për caktimin e strukturës, numrit të punonjësve dhe të shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë" dhe përdorimin e efektivitetit të fondit të pagave të Bashkisë Lezhë.

12.2. Rekomandim: Këshilli Bashkiak të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, për mos zbatimin e vendimit të KB nr. 296, datë 04.07.2016 "Për strukturën organike të Bashkisë Lezhë.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste Bashkia Lezhe ka "denaturuar" realizimin e te ardhurave, pasi në vitin 2017 ka arkëtuar nëpërmjet bankës nga 3 subjekte ndërtuese paradhënie për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën 63,000,000 lekë, pa u pajisur me leje ndërtimi, por me mendimin se këtyre subjekteve do tu jepet leja e ndërtimit në vitin 2018, pasi ata janë pronarë të truallit dhe në planin e përgjithshëm urbanistik janë parashikuar në njollat e ndërtimit respektivisht subjektet:

1. Subjekti "J....K", fatura për arkëtim nr. 44, datë 04.12.2017 në vlerën 34,000,000 lekë e firmosur nga T. M me detyrë Drejtor Finance në Bashkinë Lezhë.

2. Subjekti "T.....2", fatura për arkëtim nr. 46, datë 04.12.2017 në vlerën 25,000,000 lekë e firmosur nga T. M me detyrë Drejtor Finance në Bashkinë Lezhë.

3. Subjekti fizik "K....I" fatura për arkëtim nr. 48, datë 12.12.2017 taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja Banesë kolektive 6 katesh me bodrum në Shëngjin në vlerën 4,000,000 lekë e firmosur nga T. M me detyrë Drejtor Finance në Bashkinë Lezhë, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 57.

Nga ana e Bashkisë Lezhë sqarohet se ky arkëtim është bërë pasi kemi patur paafësi paguese dhe kemi paguar pagat e punonjësve të cilat i kemi vonuar me 2-3 muaj (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/5, faqet 116-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë në të ardhmen të mos pranojë arkëtime paradhënie në se subjektet nuk janë pajisur me leje ndërtimi. Vlera prej 63,000,000 lekë të pasqyrohet në llogarinë e furnitorëve dhe gradualisht sipas një grafiku të fillojë kthimi i këtyre shumave në rast të mos dhënies së lejes së zhvillimit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Lezhë ka kryer në vite kontabilizimin për debitorët e taksave dhe sipas bilancit kontabël më datën 31.12.2017, në llogarinë 468 –debitorë për taksat për vlerën 59,646,964 lekë, nga e cila debitorë për biznesin e vogël në vlerën 22,847,471 lekë dhe biznesi i madh në vlerën 36,799,493 lekë. Sipas inventarit që u bë nga vetë punonjësit e Drejtorisë Taksave Bashkia Lezhë, gjendja e debitorëve më datë 31.12.2017 është në vlerën 134,042,129 lekë, pra një diferencë më tepër se kontabiliteti në shumën 74,395,164 lekë, kjo pasi nuk janë ngarkuar debitorët e ish komunave për vlerën prej 44,593,000 lekë.

Për vitet 2015 dhe 2016 nga Drejtorët dhe përgjegjësit e zyrës taksave edhe pse janë nxjerrë listat e debitorëve nuk janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë, si dhe nuk është kryer rakordimi ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë Taksave, duke mos hapur analizat (partitarët), veprime në kundërshtim me:

- a. Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 6 dhe 7;
- b. VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I, ”Mbajtja e kontabilitetit”, pika 2 shkronja (c),”Dokumentet e kontabilitetit”, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”
- c. Ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”;
- d- Udhëzimi i Ministrit Financave nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve pika 3 (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/5, faqet 116-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lezhë të nxjerrë përgjegjësitë e personave të cilët nuk kanë dërguar për kontabilizime debitorët të subjekteve fizik/ juridik ndër vite.

14.2. Rekomandimi: Pas inventarizimit të përgjithshëm të debitorëve gjendje me datën 31.12.2017 për bizneset të hartohen akt rakordimet me Drejtorinë e Financës dhe të kryhen regjistrimet në kontabilitet duke u pasqyruar në Bilancin e mbylljes të vitit 2018.

Për arkëtimin e detyrimeve tatimore më datën 31.12.2017 në vlerën **134,042,129 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Departamenti Juridik Bashkia Lezhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a-Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke shtuar edhe debitorët e taksave të ish komunave.

b- Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Edhe pas njoftimeve zyrtare në se Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike), pasi të merren masat administrative apo

sekuestro te bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

e- Drejtoria e Te ardhurave Vendore në Bashki, në bashkëpunim me 9 Njësitë Administrative, respektivisht: Shëngjin, Shënkoll, Ungrej, Zejmen, Balldre, Blinisht, Dajç, Kallmet dhe Kolsh, të evidentojnë listat emërore te debitorëve ne mënyre elektronike dhe te printuar dhe në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”.të njoftojnë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

Brenda datës 31.10.2018

15. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Lezhë, rezulton se nga 18 punonjës që ka në organikë IMTV, 5 inspektorë nuk kanë arsimin e nevojshëm për të punuar në detyrën e inspektorit IMTV, respektivisht;

1. A. D, Inspektor IMTV, Bashkia Lezhë, Diplomuar në Universitetin “K.....” “Diplomë Bachelor Administrim Publik, emëruar më dt. 03.08.2016,

2. Z. GJ, Inspektor IMTV, NjA. Shëngjin, përfunduar Fakultetin për Financë-Bankë, emëruar më dt. 01.06.2017.

3. E. N, Inspektor IMTV, NjA Kallmet diplomuar në Universitetin e Shkodrës “L.....” Fakultetin e Shkencave shoqërore me vendimin e komisionit të datës 22.07.2015 “Diplomë Bachelor e Nivelit parë në Gjeografi”, emëruar më dt. 01.08.2016.

4. D. M. N, Inspektor IMTV, NjA Shënkoll, diplomuar në Universitetin “K.....” “Diplomë Bachelor Financë”, emëruar më datë 01.10.2015.

5. A. B, Inspektor IMTV, NjA. Shëngjin përfunduar Kurs 3 vjeçar, nuk ka diplomë dhe listë notash. Emërimi i 6 punonjësve të mësipërm në IMTV Lezhë nga të cilët 2 kanë përfunduar Fakultetin Ekonomik, 1 (një) Fakultetin e Edukimit, 1 (një) Fakultetin Gjeografi dhe 1 (një) kursin 3 vjeçar pa u pajisur me diplomën e shkollës lartë apo shkollës mesme për ndërtim, është në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010, ligjin nr. 10323, datë 23.09.2010, ligjin nr. 23/2013 dhe me ligjin nr. 183/2014 dhe konkretisht neni 11 (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/6.1, faqet 140-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në kuadrin e studimit për ripërcaktimin e strukturës dhe organikave të marrin masa për emërimin e inspektorëve të Inspektoratit të mbrojtjes së territorit të bëhet në përputhje me kërkesat e me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010, ligjin nr. 10323, datë 23.09.2010, ligjin nr. 23/2013 dhe me ligjin nr. 183/2014 dhe konkretisht nenin 11.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Edhe pse për vitet 2016-2017 nga Bashkia Lezhë janë dhënë 22 leje ndërtimi (përkatesisht 15 dhe 7 leje), nga ana e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkisë Lezhë, nuk janë hapur dosje për secilin subjekt, nuk ka marrë zyrtarisht nga subjektet ndërtuese dokumentacionin teknik-ligjor dhe nuk ka pajisur zbatuesin e punimeve (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.2014 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me ligjin nr. 10324, datë 23.09.2010 (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/6.1, faqet 140-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë, Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendore të shqyrtojë mangësitë në dosjet e lejeve të ndërtimit duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa për krijimin e dosjeve për secilin subjekt ndërtues të pajisur me leje ndërtimi për periudhën 2016-2017 dhe për periudhën në vazhdim, në zbatim të kërkesave të nenit 9, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.2014 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ndryshuar me ligjin nr. 10324, datë 23.09.2010.

Brenda muajit dhe Vazhdimisht

17. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2 vjeçare 2016-2017 nga ana e IMTV Lezhë janë konstatuar 137 ndërtime të kundërligjshme nga të cilat 69 kioska apo ndërtime me afat provizor 5 mujor, 70 mure rrethues dhe 4 objekte janë në proces gjyqësor. Objektet pa leje dhe që kanë dalë vendimi prishje për vitin 2016 janë gjithsej 31 objekte dhe në vitin 2017 janë 100 objekte. Këto objekte mund të jenë ndërtuar në periudha të ndryshme në kohën e ish komunave për të cilat nuk është e mundur të përcaktohen vitet e ndërtimit. Nga këto ndërtime, 40 prej tyre kanë dalë urdhrat e ekzekutimit, ku 25 ose mbi 50 % e tyre janë mure rrethues, 15 avlli dhe 10 janë kioska me konstruksion metalik, kryesisht Njësia Administrative Shëngjin.

Ndërtime të kundërligjshme për të cilët kanë dalë vendimet e prishjes që i përkasin Bashkisë Lezhë janë 37 objekte; në Njësinë Administrative-Shëngjin 101 objekte, nga të cilat 21 janë ndërtime me deklaratë paraprake punimesh, Njësinë Administrative Shënkoll janë 19 ndërtime. (*Lista e subjekteve për të cilat kanë dalë vendime prishje dhe nuk janë vendosur gjodat sipas legjislacionit në fuqi janë pasqyruar në Aneksin nr. 1, të dorëzuar në IMTV Bashkia Lezhë*) (*Trajtuar më hollësisht në pikan III/6.1, faqet 140-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendor Bashkia Lezhë, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe të rikërkohet edhe njëherë Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes Territorit, për hartimin e një plani të përbashkët veprimi duke mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme.

Për ndërtimet e kundërligjshme me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor në proces verbalet e konstatimit të vendoset edhe sipërfaqja në (m²) dhe vlerën e preventivit të punimeve, duke e shumëzuar me koston e Entit Kombëtar të Banesave për qytetin e Lezhës, siç përcaktohet në ligjin nr. 107/2014, datë 01.10.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017 neni 52 "Kundërvajtjet administrative", pika 2.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2 vjeçare për vitet 2016-2017, nga ana e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Lezhë janë vendosur 25 gjoda në vlerën 7,200,000 lekë, të cilat janë dërguar në zyrën e financës dhe janë kontabilizuar.

Nga vlera e mësipërme janë arkëtuar 12 gjoda në vlerën 1,550,000 lekë dhe nuk janë arkëtuar 13 gjoda në vlerën 5,650 000 lekë, prej tyre 7 gjoda në vlerën 3,500,000 lekë janë dërguar në Zyrën e Përmbarimit, 4 gjoda në vlerën 1,550,000 lekë janë në proces gjyqësor, ndërsa vendimi i gjobës nr. 000023, datë 07.09.17 vendosur ndaj subjektit "M....." për ndërtimin pa leje me objekt: "Ndërtim Mure tulle, kolona betoni, themele betonarme pa soletë" për vlerën 500,000 lekë pa u mbështetur në dispozitë ligjore.

Konstatohet se për vendimet e gjobave të cilat janë dërguar në gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv, nuk janë llogaritur kamatëvonesa në masën 60% të vlerës dhe për pasojë Gjykata në vendimet e nxjerra prej saj, kundërvajtësit nuk janë ngarkuar me kamat vonesa në kundërshtim me:

a-nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, përcaktohet se: -Gjoda paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka

marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamata 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni) (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2) (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10324, datë 23.9.2010, neni 3) *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/6.1, faqet 140-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit vendor (IMTV) Bashkia Lezhë, të vazhdojë procedurat për arkëtimin e **25 gjobave në vlerën 7,200,000 lekë**. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përlllogariten edhe kamata vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, sipas përcaktimeve në nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve".

Brenda datës 31.10.2018

19. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Lezhë, rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 31,116,980 lekë, nga 19 masa për shpërblim demi të rekomanduara në vlerën 31,116,980 lekë, janë pranuar plotësisht 11 masa në shumën 8,479,693 lekë, nga të pranuarat janë zbatuar pjesërisht 3 masa, nga të cilat është arkëtuar shuma 2,913,183 lekë, si dhe mos marrjen në konsideratë e rekomandimeve të pikës B "Masa për Shpërblim Demi" në 22 raste për vlerën 5,367,388 lekë *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/1, faqet 11-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Për rekomandimet e pa zbatuara në Bashkinë Lezhë të vazhdojnë procedurat për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara dhe hartimin e padive gjyqësore për rastet e mos pagimit në mënyrë vullnetare të dërguara në Bashkinë Lezhë nga KLSH me shkresën 32/6, datë 30.04.2015, rikërkuar me shkresën nr. 1113/111 datë 31.01.2017 dhe trajtuar më hollësisht në akt verifikimin nr. 01, datë 27.04.2018 "Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve në auditin e mëparshëm".

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Në ish- Komunën Balldren i RI, aktualisht Njësi administrative në Bashkinë Lezhë, nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Lezhë në të cilën përfshihet njësi Administrative Balldren i Ri, të marrë masa dhe të ngrejë grup pune për të negociuar kontratën me operatorin C..... Njëkohësisht ti kërkoj zyrtarisht operatorit "C.....", pagesën e shumës prej **423,235,000 lekë**, dëm ekonomik krijuar buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përdorimit të referencave dhe tarifave të gabuara në dhënien me qira të pasurive komunare, për sipërfaqen prej 4.12 ha dhe 16.65 ha, si dhe tejkallim të kompetencave në dhënien në përdorim pa përcaktuar pagesë, për sipërfaqen prej 29 ha, në të kundërt çështja të ndiqet zyrtarisht në gjykatë.

Nga verifikimi rezultoi se: Është realizuar pjesërisht, pasi është kryer kontabilizimi por nuk është arkëtuar shuma dhe nuk është ngritur grup pune për të negociuar kontratën me këtë operator. Ka dalë Njoftim Detyrimi i Kryetarit të Bashkisë Lezhë nr.6992, datë 24.12.2015 për Shoqërinë "C.....", ku kërkohet të zhdëmtohet shuma 423,235,000 lekë. Për këtë Shoqëria "C....." ka paditur Bashkinë Lezhë në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Shkodër. Gjykata nga ana e saj nuk e ka pranuar këtë padi për arsye se "shkresa është thjeshtë një njoftim dhe nuk ka fuqi detyruese".

Për sa më sipër ka dalë VKM nr.844, datë 14.10.2015 "Për heqjen nga fondi kullësor kombëtar të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë kullësore "Mali i Rencit-Kakarriq" Balldre, Lezhë që do të përdoret nga Shoqëria "C.....", për shfrytëzimin e gurit gëlqeror".

Për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH, referuar raportit përfundimtar të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, subjektit C..... i është bërë njoftimi i detyrimit nr. 6992, prot datë 24.12.2015

Njoftim i goditur nga shoqëria C..... në gjykatën administrative të shkallës së parë Shkodër me vendimin nr. 164(112) datë 01.03.2016, ku ne arsyetimin e këtij vendimi është shprehur “ Duke parë situatën faktike në raport me përcaktimin e me sipërm, gjykata çmon se shkresa njoftim për shlyerje dëmit e shkaktuar, njoftim detyrimi nr. 6992 prot, datë 24.12.2015 për përmbushje vullnetare te demit ne vlerën 423,235,000 lekë, nuk është akt administrativ.

Gjithashtu dhe raporti auditit nr. 767/12 prot, i Kontrollit të Lartë te Shtetit, në programin e tij gjetje dhe rekomandime për institucionet shtetërore siç dhe ka dhënë. Kjo analize është bërë nga gjykata në funksion të përfundimit të arritur se Urdhri i Zhdëmtimit (Njoftimi i Detyrimit) si dhe të aktet e tjera, rezultatet e kontrolleve, rekomandimet dhe shkresat e auditit nuk përbejnë në vetvete veprime të tjera administrative pasi jenë akte të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë se organeve shtetërore.

Siç e theksua në citimin e vendimit të gjykatës Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime mbi gjetjet dhe në konfirmimin e tij. Kryetari i KLSH në shkresën nr.767/12 me lëndë: Raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet në zbatim të ligjit për KLSH nr. 154/2014 është shprehur: “Ju rekomandojë dhe kërkojmë zbatimin e masave të mëposhtme.

Përlllogaritja e dëmit në zbatim të kreut 3 (përcaktimi i tarifës dysHEME) të VKM nr. 1712 datë 24.12.2008 “Për dhënie me qira ose emfiteoze te pasurive shtetërore”, pika 1 germa (a) Për ndërtesat; “Jashtë vijave kufizuese te bashkive jo me pake se 100/lekë m² muaj”. Në zonën e dhënë me qira nuk ka dhe nuk ka pasur asnjë ndërtese dhe linjë, çdo veprim është kryer në zbatim të ligjit minerar nr. 7796, datë 17.2.1994 i ndryshuar dhe lejes se shfrytëzimit minerar nr. 1276 datë 02.12.2008, përkatësisht neni 52 qe i jep të drejtë zotëruesit të lejes së shfrytëzimit:

Pretendimi përfundimtar është se diferenca që duhet kërkuar shoqërisë C..... është në vlerën 832,500 x 7 vite = 5,827,500 lekë dhe jo vlera e rekomanduar nga KLSH prej 423,235,000 lekë.

Bashkia Lezhë nuk ka bërë apelim, pasi vlera e pagesës së tarifës gjyqësore është e lartë prej 4,232,350 lekë (423,235,000 lekë x 1%)

20.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë, të bashkëpunojë me Avokaturën e Shtetit për të ndjekur në rrugë ligjore arkëtimin nga shoqëria C..... të shumës prej 423,235,000 lekë, rekomandim i KLSH dërguar me shkresën nr. 767/12 prot, datë 03.12.2015 dhe të auditimit lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga ky auditim, dërguar me shkresën nr. 1113/50 prot, datë 25.12.2016, si dhe të detyrimeve shtesë të lindura në periudhën 2016 – 2017, sipas përcaktimeve në “Akt-Marrëveshjen për dhënien për përdorim të truallit pronë e Komunës Balldre”, neni 11-Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Menjëherë

21. Rekomandimi: Bashkia Lezhë, në rast se zbatimi i rekomandimeve kalon në procedura gjyqësore të njoftojë KLSH-në me shkresë zyrtare, në cilësinë e palës së tretë që ka njohuri për çështjen që nis gjykimi.

Vazhdimisht

B.I MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohe në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në

të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,403,953 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitim i pjesshëm sipas projekteve “Skema ujëtëse Mat-Lezhë, kanal sekondar”, “Skemë shpërndarje rrjeti II Kotërr-Rraboshte dhe “Sistemi i shpërndarjes i rezervuarit Kallmet dhe Fishtë”, konstatohet se fondi limit i hartuar nga shoqëria “A.....” & “E.....” me ing. B. H për vlerën e projektit prej 56,500,000 lekë është rënduar për vlerën 235,410 lekë, pasi disa zëra të analizës së çmimeve nuk janë sipas çmimeve të manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, duke rënduar padrejtësisht buxhetin e Bashkisë Lezhë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/4, faqet 65-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **235,410 lekë** nga shoqëria “A.....A” & “E.....” me ing. B. H.

Brenda datës 31.10.2018

2. Gjetje nga auditimi: Në kontratën nr. 6872/2, datë 25.8.2017 në tenderi me objekt: “*Blerjen e dy mjeteve (kamion vetëshkarkues dhe kamion me vinç vetëshkarkues*”, afati për kryerjen e furnizimit të mallit është 15 ditë kalendarike, nga data e nënshkrimit të kontratës. Me datë 20.10.2017 shoqëria “L.....” ka dorëzuar mallin ose 50 ditë vonesë.

Ndaj subjektit nuk është llogaritur penaliteti për mos dorëzim të mallit në afatin e përcaktuar në kontratë në vlerën **744,000 lekë**, veprime në dëm të buxhetit të Bashkisë Lezhë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/4, faqet 65-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **744,000 lekë** nga subjekti “L.....7”.

Brenda datës 31.10.2018

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “*Ndërtim ujësjellësi fshati Troshan*” Bashkia Lezhë, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe shoqërisë “A.....”, u konstatua se rezultojnë diferenca në volume për punime të pakryera inxhinierike duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **1,210,543 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/4.1, faqet 110-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi. Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim e Zhvillim Territorit dhe atë juridike, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **1,210,543 lekë** nga subjekti “A.....”, për diferenca në volume për punime të pakryera inxhinierike në zbatimin e kontratës “*Ndërtim ujësjellësi fshati Troshan, Bashkia Lezhë*”.

Brenda datës 31.10.2018

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e blloqeve të gjobave të Policisë Bashkiake, konstatohet se në dy raste blloqet nuk janë dorëzuar nga personat përgjegjës. Nga Zyra e Financës Bashkia Lezhë ndaj këtyre 2 punonjësve të Policë Bashkiake është mbajtur procesverbalë për humbjen e blloqeve të gjobave për vlerën 5,000 lekë/fleta, për vlerën totale prej 214,000 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 “Për shtypjen e letrave me vlerë”, i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 06.04.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.06.2014 dhe UNF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik”, kreu III, pikat 61 deri 72.

Gjithashtu konstatohet se nga gjobat e aplikuara nuk është bërë i mundur arkëtimi i vlerës së gjobave të mbetura në vlerën 144,000 lekë për 134 raste, në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 dhe 30, të ligjit nr.

10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (Trajtuar më hollësisht në pikën III/5.2, faqet 123-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së gjobave të mbetura në vlerën **144,000 lekë për 134 raste**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30, sipas pasqyrave Aneks 5/2a dhe b, bashkëlidhur Raport Auditimit.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së gjobave të mbetura në vlerën **214,000 lekë**, respektivisht;

-vlera **165,000 lekë**, në ngarkim të T. N, dhe

-vlera **49,000 lekë**, në ngarkim të L. P me detyrë polic i Policisë Bashkiake Lezhë.

Brenda datës 31.10.2018

B.II MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1- Gjetje nga auditimi: Në procedurat e audituara të prokurimeve të periudhës 2016 -2017, u konstatua se në **4 procedura** prokurimi janë evidentuar mospajtimet e dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike, pasi Autoriteti Kontraktor (AK) ka skualifikuar operator ekonomik për aspekte që formalisht përputhen me përcaktimet ligjore por që mund të trajtoheshin lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.” të cilat do të krijonin mundësinë e shpalljes fitues të OE të skualifikuar me ofertë më të ulët, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura fituese në vlerën totale të fondit limit 178,717,512 lekë me efekt në shumën **21,776,455 lekë** që përfaqësojnë mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet i fondeve, të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriteret të paplota, respektivisht në procedurat (Trajtuar më hollësisht në pikën III/4, faqet 65-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Tenderi me objekt:** “Rikonstruksion i shkollës së mesme bashkuar Zejmen”, me fond limit 38,203,590 lekë të zhvilluar në vitin 2017, ku fitues është shpallur shoqëria “N.....+ B.....” me vlerë kontrate 37,436,051 lekë.

a-Në vendosjen e disa kriterëve janë konstatuar parregullsi, pasi nuk janë në përshtatje me zërat e preventivit, duke vendosur kategori licencë e cila nuk përputhet me volumin e zërave të punimeve (NP-3C, NP-12CNS-4C), si dhe prezenca e 3 (tre) fadromave, 2 (dy) ekskavator dhe një bocat, pa asnjë analizë mbi argumentimin e këtyre makinerive.

b-Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit dhe sistemin elektronik të APP, konstatohet se edhe BOE “N.....+ B.....” nuk plotëson kriteret e DST, konkretisht: -Nga shoqëria “B.....” nuk rezulton që në licencën e saj të jenë kategoritë e licencës NP-1B, NP-3C, NP-12B, NS-4S, NS-10A dhe NS-14A, ku referuar kontratës së bashkëpunimit nr. 8642rep/6759kol, datë 18.9.2017, kjo shoqëria ka marrë përsipër kryerjen e punimeve për të cilat kërkohet kategoritë e mësipërme; -Referuar zërave të preventivit për punët e marrë përsipër, shoqëria “B.....” ka punime për shtresa pllaka, për të cilën në

referencë të kërkesave të DST, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike me vlerën **2,044,807 lekë**.

- **Tenderi me objekt:** “*Grumbullim, transportim i mbetjeve urbane, seleksionim i mbetjeve të riciklshme, depozitim i mbetjeve pariciklshme në landfil në zonën Balldre, Kallmet, Dajc, dhe Ungrej (zona III)*”, me fond limit 50,563,304 lekë të zhvilluar në vitin 2017, ku fitues është shpallur shoqëria “L.....7” me vlerë kontrate 43,886,440 lekë.

Shoqëria “L.....7” e shpallu fitues nga KVO, nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura nga NJP dhe miratuara nga AK, si vijon: -Nuk është paraqitur mjeti me vinç të instaluar pas kabinës; -Nuk plotëson kapacitetin teknik “Përvojë e suksesshme në realizimin e kontratës”.

Në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, midis operatorëve me mangësi (subjekti “P.....O” me ofertë 37,804,757 lekë), të vlerësohej kriteri kryesor “*çmimi i leverdishëm*”, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **6,081,683 lekë**, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE

- **Tenderi me objekt:** “*Grumbullim, transportim, depozitim dhe trajtim i mbetjeve urbane në zonën Shënkoll - Zejmen - Kolsh të Bashkisë Lezhë (zona II)*”, me fond limit 60,000,000 lekë të zhvilluar në vitin 2017, ku fitues është shpallur shoqëria “V.....G + P.....O” me vlerë kontrate 56,940,480 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se shpallja fitues e BOE “V.....G + P.....O”, nuk është në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, pasi ky BOE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit dhe miratuara nga AK, si vijon: -Nuk argumentohet me foto mjetet teknologjike që do përdoren për transportin e mbeturinave të riciklshme dhe pariciklshme; - Shoqëria “P.....O” e cila ka 70% të punimeve sipas marrëveshjes nuk ka paraqitur asnjë mjet sipas kërkesave të DST, nuk paraqet leje mjedisore e tipit (C) ‘Për pastrim, grumbullim, transportim i mbetjeve’, por paraqet autorizim; -Shoqëria “V.....”, bilancet financiare nuk janë me akt-ekspertizë, siç kërkohet më pikën 2.1 të DST; - Shoqëria “V.....”, Certifikatat e lëshuar ISO nuk janë për aktivitetin e objekti të prokurimit, për të cilën është s’kualifikuar dhe OE “B..... B”.

Në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, midis operatorëve me mangësi të vlerësohej kriteri kryesor “*çmimi i leverdishëm*”, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **13,038,648 lekë**.

- **Tenderi me objekt:** “*Furnizim me artikuj ushqimor për kopshte dhe çerdhe, konvikt viti 2017*”, me fond limit 8,593,877 lekë të zhvilluar në vitin 2017, ku fitues është shpallur shoqëria “L.....7” me vlerë kontrate 8,331,400 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin APP, konstatohet se ky operator nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht: -Nuk është paraqitur ekstrakti i shoqërisë; -Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi ai nuk është për kontratën e shoqërisë “L.....7”.

Në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, midis operatorëve me mangësi të vlerësohej kriteri kryesor “*çmimi i leverdishëm*”, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në vlerën **571,317 lekë**.

1.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Lezhë, të marrë masa që KVO në të ardhmen të jenë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave për kualifikim, sidomos ato të veçanta, dhe të mos hezitojë të kërkojë informacione shtesë dhe shpjegime nga OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të Bashkisë Lezhë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar duke u mbështetur në përcaktimet e kuadrit rregullator në fuqi për trajtimin e deviacioneve të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës me qëllim kursimin e fondeve.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimit nr. 189, datë 19.02.2016 në favor të firmës private “K.....”, përfaqësuar nga M. N për shtesë kontrate në objektin “Ndërtim tregu në Komunën Kolsh Lezhë” kapitulli 01 kodit 4250 është likuiduar vlera 14,249,084 lekë, mbështetur me vendim Gjykatës Administrative të Shkallës parë Tiranë nr. 253, datë 28.01.2014, vendim i cili nuk është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Në bilanc janë pasqyruar detyrim për ndërtimin e tregut në vlerën 13,424,460 lekë që i përket kontratës bazë. Shtesa e Kontratës është likuiduar me vendimin e gjykatës në vlerën 14,249,084 lekë nga 15,167,915 lekë (sipas vendimit) dhe mbeten pa u likuiduar dhe 918,831 lekë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/3, faqet 53-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë (Nëpunësi autorizues) të eliminojë praktikën të zbatimit të vendimeve gjyqësore pa ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, veprime që çojnë në mospërdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe të merren masa për të vënë para përgjegjësisë nëpunësit shkaktarë që me veprimet e mosveprimet e tyre krijojnë konflikte gjyqësore dhe Bashkia humbet gjyqet dhe detyrohet të rrisë shpenzimet e paprogramuara që çojnë në disbalancimin e buxhetit të vitit ushtrimor përkatës.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimi nr. 113, datë 09.02.2016 është likuiduar vlera 995,658 lekë në favor të shoqërisë “F.....”, me objekt “Shërbimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara në qytet dhe mjediset urbane”, për amendim të kontratës nr. 1146, datë 01.07.2011, neni 13.

Likuidimi është kryer i pa mbështetur në ditarin e punimeve dhe bilancin e firmës private në tërësi (Për të gjithë aktivitetin) për të argumentuar humbjen e pësuar. Edhe pse, në kontratë është përcaktuar përballimi i rritjes së pagave, çmimit të karburantit dhe çmimit të ujit, nga Bashkia nuk është ndjekur i njëjti standard për të gjitha kontratat shumëvjeçare dhe në këto kushte përbën përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Në këto kushte edhe pse është lidhur kjo kontratë (aktualisht e mbyllur) nuk është treguar kujdesi i duhur në DST, për pjesën e përballimit të inflacionit (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/3, faqet 53-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe Drejtoria Juridike, të marrë masa për përcaktimin e kriterëve të qarta për financim të humbjeve nga inflacioni në DST, të kontratave shumëvjeçare, pasi në bilancet e certifikuara nga Drejtoria Rajonale e Taksave humbja e vitit të mëparshëm është e pasqyruar në bilanc (Të ardhurat dhe shpenzimet).

Vazhdimisht

4. Gjetje nga auditimi: Në favor të T. N është likuiduar vlera 5,000,000 lekë sipas urdhër shpenzimeve, kjo në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Shkodër nr. 163, datë 01.03.2016, i cili ka marrë formë të prerë me datë 17.03.2016 dhe nuk ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Shkallës parë Shkodër ka vendosur që Bashkia Lezhë (Njësia Administrative Shëngjin), të shpërblej për dëmin jashtë kontraktorë të shkaktuar si pasojë e vendimit nr. 73, datë 26.03.2012 të Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), për prishjen e objektit 2-katësh (ndërtesë dërrasë, bar restorant “Brazili” në Kune-Lezhë), në vlerën 7,665,186 lekë i ndarë në dy këste. (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/6.1, faqet 140-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë (Nëpunësi autorizues) dhe Drejtoria Juridike të eliminojnë praktikën të zbatimit të vendimeve gjyqësore pa ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, veprime që çojnë në mospërdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe të merren masa për të vënë para përgjegjësisë nëpunësit shkaktarë që me veprimet e mosveprimet e tyre krijojnë konflikte

gjyqësore dhe Bashkia humbet gjyqet dhe detyrohet të rrisë shpenzimet e paprogramuara që çojnë në disbalancimin e buxhetit të vitit ushtrimor përkatës.

Vazhdimisht

B. III MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme në bashkinë Lezhë, rezulton se nuk janë kryer kontabilizimit dhe nuk është arkëtuar nga 2 subjekte ndërtues taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **25,356,743 lekë dhe konkretisht:**

a- Në lejen zhvillimore “*Godinë Banimi dhe Shërbimi 1-10 kate + 1 kat Podrum (Seksioni B-1)*” Bashkia Lezhë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi llogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se kjo është paguar pjesërisht ose nuk është paguar vlera **12,247,743 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me ligjin nr. 107/204 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, neni 46, pika 2.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Bashkisë Lezhë, Kryetari i Bashkisë, ka dalë njoftim nr. 5337, datë 22.06.2016, drejtuar shoqërisë ndërtuese “A.....”, ku kërkohet arkëtimi i menjëhershëm i taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe nga shuma e rekomanduare prej **12,247,743 lekë** deri më datën 20.04.2018 është arkëtuar shuma prej 2,500,000 lekë duke mbetur për tu arkëtuar edhe shuma prej **9,747,743 lekë**.

b- Nga auditimi rezulton se nuk është zbatuar rekomandimi dërguar me shkresën nr. 438/6, datë 13.09.2013 të KLSH, për masa shpërblim dëmi në vlerën **15,609,000 lekë** nga subjekti “**Û.....S**”, për mos pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturë dhe penalitete 2 (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/1, faqet 11-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi për gjetjet 1 dhe 2:

a. Bashkia Lezhë të marrë masa të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë gjyqësore shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **15,609,000 lekë** nga subjekti “**Û.....**”, për mos pagesën e taksës së ndikimit të i infrastrukturë dhe penalitete.

b. Bashkia Lezhë të marrë masa të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë gjyqësore shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **9,747,743 lekë** nga subjekti “**A.....N**”, për mos pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturë. (Pasi nga shuma e rekomanduare prej **12,247,743 lekë** deri më datën 20.04.2018 është arkëtuar shuma prej 2,500,000 lekë duke mbetur për tu arkëtuar edhe shuma prej 9,747,743 lekë)

c. Bashkia Lezhë, Drejtoria e Planifikimit Territorit, Drejtoria e Të ardhurave dhe Drejtoria e Financës për mos pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 2 subjektet respektivisht: nga subjekti “**Û.....**” për vlerën **15,609,000 lekë** dhe subjekti “**A.....**” për vlerën e mbetur prej **9,747,743 lekë**, të nxjerrin Njoftim vlerësimet përkatëse dhe të ndjekin **procedurat e mëposhtme:**

a. T’i dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

b. T’i dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c. Në se 2 subjektet e mësipërme nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Bashkisë Lezhë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike), bazuar në pikën 1, neni 114 -Mospagimi në afat i

detyrimin tatimor apo i kontributit, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH” të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, pasi të merren masat administrative duke i ngarkuar me një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, por jo më tepër se 365 ditë, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Brenda datës 31.10.2018

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Juridike ka lidhur kontrata të reja në vitin 2017 për dhënie me qira të hapësirës së plazhit pa bërë të mundur likuidimin e detyrimeve të vitit 2016 në shumën 4,637,200 lekë, veprime në kundërshtim me pikën 3 e nenit 4, të VKM nr. 369, datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë.

Konstatohet se 29 subjekte për sipërfaqen 18251 m², nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës për vitet 2016 - 2017, në vlerën 8,373,000 lekë dhe kamat vonesa të llogaritura në vlerën 546,977 lekë, gjithsej **8,919,997 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Lezhë, veprim në kundërshtim me kushtet e kontratave dhe nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore, Bashkia Lezhë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **8,919,997 lekë** nga **29 subjektet** dhe në rast mos pagese të prishet kontrata, sipas pasqyrës aneks 7/1, bashkëlidhur Raport Auditimit,.

Brenda datës 30.09.2018

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lezhë ka lidhur kontratë qiraje nr 10676, datë 05.12.2017 pa noter me shoqërinë “S.....” me, për përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor/kullor prej 2.067 ha në pronësi të Bashkisë Lezhë, për ndërtim linje tensioni me gjatësi 3.2 km shtrije tubacioni me gjatësi 2.972 km, dhe ndërtim rruge 1.773 km. Afati i kontratës është 1 vjeçar me vlerë qiraje vjetore 971,690 lekë, llogaritur sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhjes 2, pika 11/5, kur në fakt vlera e kontratës duhet të llogaritej për vlerën 1,277,105 lekë. Diferenca për vlerën **305,415 lekë** (1,277,105 lekë – 971,690 lekë), konsiderohet dëm për buxhetin e Bashkisë, në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave” *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **305,415 lekë** nga shoqëria “S.....R ”, në zbatim të kontratës nr. 10676, datë 05.12.2017 dhe të nënshkruar nga noteri.

Brenda datës 31.10.2018

4. Gjetje nga auditimi: Ish- Komuna Zejmen sot Njësia Administrative Zejmen Bashkia Lezhë, ka lidhur kontrata për dhënie me qira të sipërfaqeve pyjore për mbarëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, u konstatua se 2 subjekte për sipërfaqen 1.615 ha nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës për vitin 2016 - 2017, në vlerën 130,140 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë, nga e cila: Z.K për kontratë nr. 537, datë 23.04.2013, me sipërfaqe 1 ha për vlerë 108,000 lekë dhe GJ. M për kontratë nr. 1091, datë 05.05.2015, me sipërfaqe 0.615 ha për vlerën 22,140 lekë, veprim në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” *(Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **130,140 lekë**, respektivisht”
-vlera **108,000 lekë** nga subjekti “Z.K”;
-vlera **22,140 lekë** nga subjekti “GJ. M”.

Brenda datës 31.10.2018

5. Gjetje nga auditimi: Ish -Komuna Kolsh sot Njësia Administrative Kolsh, ka lidhur kontratë qiraje nr. 4123, datë 11.12.2014 (para noterit), me subjektin “G.....L” përfaqësuar nga A. N, për dhënie me qira të objektit “*Tregu Rajonal Agro-Ushqimor*” me sipërfaqe ndërtese 1364 m² dhe sipërfaqe trualli 6046 m² dhe afat përdorimi për një periudhë 20-vjeçare.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, u konstatua se subjekti “G.....L” nuk ka paguar detyrimet e kontratës për vlerën 866,516 lekë për periudhën e 6 mujorit të dytë 2015, në kundërshtim kushtet e kontratës nr. 4123, datë 11.12.2014.

Për vitet 2016 - 2017, sipas kontratës subjekti nuk ka shlyer shumën 6,301,872 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Lezhë, duke mos u pasqyruar si debitor në llogarinë nr. 468 “*Debitor të ndryshëm*”, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në total detyrimi paarkëtuara për periudhën 2015 – 2017 paraqitet në **vlerën 7,168,388 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **7,168,388 lekë** nga subjekti “G.....L” përfaqësuar nga A. N, që rrjedhin nga kontrata e qirasë nr. 4123 datë 11.12.2014.

Brenda datës 31.10.2018

6. Gjetje nga auditimi: Subjekti ndërtues “I.....N” vendndodhja Njësia Administrative Shenkoll me pronar z. F. B, pajisur me leje zhvillimi nr. 93, dt. 30.09.2011, i ka përfunduar afati. Me procesverbalin nr. 19, datë 28.08.2017 është konstatuar ndërtim pa leje i objektit “*Hotel 4 kat dhe ndërtim kati shtesë pa leje mbi objektin ekzistues me sipërfaqe 300 m²*”, mbajtur nga inspektorët A. Z dhe M. N.

Nga IMT Lezhe është marrë Vendim Prishje nr. 125, datë 06.09.2017 dhe vendim gjobe nr. 000022, datë 06.09.2017 në vlerën 500,000 lekë, gjoba e cila është në proces ekzekutimi nëpërmjet zyrës përmbarimit. Ndërkohë për këtë shkelje nga IMTV duhej të vendosej gjobë në vlerën e preventivit 300 m² x 32,436 lekë/m² ose e barabartë me vlerën 9,730,800 lekë, bazuar në koston mesatare të ndërtimit, të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave (ku për qytetin e Lezhës është në vlerën 32,436 lekë/m², sipas udhëzimit KM nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016”), duke mos zbatuar ligjin nr. 107/2014, datë 01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017 neni 52, Kundërvajtjet administrative pika 2 (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/6.1, faqet 140-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Lezhë, ndaj subjektit ndërtues “I.....N” vendndodhja Njësia Administrative Shënkoll me pronar z. F. B i cili ka ndërtuar pa leje mbi objektin ekzistues “*Hotel 4 kate, katin shtesë me sip 300 m²*”.

Duke qenë se sipërfaqja 300 m² shtesë kati pa leje është me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, subjekti ndërtues “I.....N”, duhet të dënohet me gjobë në vlerën e punimeve të kryera pa leje ose në shumën **9,230,000 lekë**, duke zbritur vlerën e gjobës 500,000 lekë (9,730,000-500,000), mbështetur në ligjin nr. 107/2014, datë 01.10.2014”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017 neni 52, Kundërvajtjet administrative pika 1.

Brenda datës 31.10.2018

7. Gjetje nga auditimi: Ne auditimin e procedurave për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, u konstatua se nga Bashkia Lezhë nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme shtrënguese në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, nenet 70, 90, 91, 114, ligjit nr. 9482, datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, për vlerën e detyrimit të paarkëtuara në shumën **134,042,129 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/5, faqet 116-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandimi: Bashkia Lezhë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa e nevojshme shtrënguese për vjeljen e detyrimeve të paarkëtuara në shumën 134,042,129 lekë.

Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH, i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

Brenda datën 30.09.2018

8. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Kolsh, sot Njësia Administrative Kolsh Bashkia Lezhë, gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2013 ka lidhur kontrata pa vlerë me 38 persona për sipërfaqen 86.92 ha, me afat 10 vjeçare, për përmirësimin e fondit pyjorë dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera, detyrimi i llogaritur dhe i papaguar për periudhën objekt auditimi (viti 2016 dhe 2017) në vlerën **3,042,480 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; ligjin nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kulloror”; VKM nr 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/7, faqet 152-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Agjencia e Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Lezhë, të marrë masa për ndryshimin e kontratave, duke përcaktuar vlerën e kontratës në bazë të tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave për arkëtimin e detyrimit të pallogaritur për periudhën objekt auditimi në vlerën 3,042,480 lekë, sipas pasqyrës Aneks 7/3 bashkëlidhur Raport Auditimit.

Ne rast mos pagese të ndiqen procedurat ligjore për lirimin e pronës dhe prishje të kontratës.

Brenda datës 31.10.2018

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2 vjeçare për vitet 2016-2017, nga ana e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Lezhë janë vendosur 25 gjoba në vlerën 7,200,000 lekë, të cilat janë dërguar në zyrën e financës dhe janë kontabilizuar.

Nga vlera e mësipërme janë arkëtuar 12 gjoba në vlerën 1,550,000 lekë dhe nuk janë arkëtuar 13 gjoba në vlerën 5,650 000 lekë, prej tyre 7 gjoba në vlerën 3,500,000 lekë janë dërguar në Zyrën e Përmbarrimit, 4 gjoba në vlerën 1,550,000 lekë janë në proces gjyqësor, ndërsa vendimi i gjobës nr. 000023, datë 07.09.17 vendosur ndaj subjektit “M.....” për ndërtimin pa leje me objekt: “*Ndërtim Mure tulle, kolona betoni, themele betonarme pa soletë*” për vlerën 500,000 lekë pa u mbështetur në dispozitë ligjore.

Konstatohet se për vendimet e gjobave të cilat janë dërguar në gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv, nuk janë llogaritur kamatëvonesa në masën 60% të vlerës dhe për pasojë Gjykata në vendimet e nxjerra prej saj, kundërvajtësit nuk janë ngarkuar me kamat vonesa në kundërshtim me:

a-nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, përcaktohet se: -Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni 1)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10324, datë 23.9.2010, neni 3) (Trajtuar më hollësisht në pikën III/6.1, faqet 140-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit vendor (IMTV) Bashkia Lezhë, të vazhdojë procedurat për arkëtimin e **25 gjobave në vlerën 7,200,000 lekë**. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, sipas përcaktimeve në nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve".

Brenda datës 31.10.2018

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Lezhë, rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 31,116,980 lekë, nga 19 masa për shpërbllim dëmi të rekomanduara në vlerën 31,116,980 lekë, janë pranuar plotësisht 11 masa në shumën 8,479,693 lekë, nga të pranuarat janë zbatuar pjesërisht 3 masa, nga të cilat është arkëtuar shuma 2,913,183 lekë, si dhe mos marrjen në konsideratë e rekomandimeve të pikës B "Masa për Shpërbllim Demi" në 22 raste për vlerën 5,367,388 lekë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/1, faqet 11-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Për rekomandimet e pa zbatuara në Bashkinë Lezhë të vazhdojnë procedurat për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara dhe hartimin e padive gjyqësore për rastet e mos pagimit në mënyrë vullnetare të dërguara në Bashkinë Lezhë nga KLSH me shkresën 32/6, datë 30.04.2015, rikërkuar me shkresën nr. 1113/111 datë 31.01.2017 dhe trajtuar më hollësisht në akt verifikimin nr. 01, datë 27.04.2018 "Për verifikimin e zbatimit rekomandimeve në auditin e mëparshëm".

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në ish- Komunën Balldren i RI, aktualisht Njësi administrative në Bashkinë Lezhë, nga KLSH i është rekomanduar Bashkisë Lezhë në të cilën përfshihet njësi Administrative Balldren i Ri, të marrë masa dhe të ngrejë grup pune për të negociuar kontratën me operatorin C..... Njëkohësisht ti kërkoj zyrtarisht operatorit "C.....", pagesën e shumës prej **423,235,000 lekë**, dëm ekonomik krijuar buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përdorimit të referencave dhe tarifave të gabuara në dhënien me qira të pasurive komunare, për sipërfaqen prej 4.12 ha dhe 16.65 ha, si dhe tejkalim të kompetencave në dhënien në përdorim pa përcaktuar pagesë, për sipërfaqen prej 29 ha, në të kundërt çështja të ndiqet zyrtarisht në gjykatë.

Nga verifikimi rezultoi se: Është realizuar pjesërisht, pasi është kryer kontabilizimi por nuk është arkëtuar shuma dhe nuk është ngritur grup pune për të negociuar kontratën me këtë operator. Ka dalë Njoftim Detyrimi i Kryetarit të Bashkisë Lezhë nr.6992, datë 24.12.2015 për Shoqërinë "C.....", ku kërkohet të zhdëmtohet shuma 423,235,000 lekë. Për këtë, Shoqëria "C.....A" ka paditur Bashkinë Lezhë në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Shkodër. Gjykata nga ana e saj nuk e ka pranuar këtë padi për arsye se "shkresa është thjeshtë një njoftim dhe nuk ka fuqi detyruese".

Për sa më sipër ka dalë VKM nr.844, datë 14.10.2015 “Për heqjen nga fondi kullor kombëtar të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë kullorë “Mali i Rencit-Kakarriq” Balldre, Lezhë që do të përdoret nga Shoqëria “C.....A”, për shfrytëzimin e gurit gëlqeror”.

Për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH, referuar raportit përfundimtar të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, subjektit C.....A i është bërë njoftimi i detyrimit nr. 6992, prot datë 24.12.2015 Njoftim i goditur nga shoqëria C.....A në gjykatën administrative të shkallës së parë Shkodër me vendimin nr. 164(112) datë 01.03.2016, ku në arsyetimin e këtij vendimi është shprehur “ Duke parë situatën faktike në raport me përcaktimin e me sipërm, gjykata çmon se shkresa njoftim për shlyerje të dëmit e shkaktuar, njoftim detyrimi nr. 6992 prot, datë 24.12.2015 për përmbushje vullnetare të dëmit në vlerën 423,235,000 lekë, nuk është akt administrativ.

Gjithashtu dhe raporti auditit nr.767/12prot, i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në programin e tij gjetje dhe rekomandime për institucionet shtetërore siç dhe ka dhënë. Kjo analize është bërë nga gjykata në funksion të përfundimit të arritur se Urdhri i Zhdëmtimit (Njoftimi i Detyrimit) si dhe të aktet e tjera, rezultatet e kontrolleve, rekomandimet dhe shkresat e auditit nuk përbejnë në vetvete veprime të tjera administrative pasi janë akte të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organeve shtetërore.

Siç e theksua në citimin e vendimit të gjykatës Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime mbi gjetjet dhe në konfirmimin e tij. Kryetari i KLSH në shkresën nr.767/12 me lëndë: Raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet në zbatim të ligjit për KLSH nr. 154/2014 është shprehur: “Ju rekomandojë dhe kërkojmë zbatimin e masave të mëposhtme.

Përlllogaritja e dëmit në zbatim të kreut 3 (përcaktimi i tarifës dysheme) të VKM nr. 1712 datë 24.12.2008 “Për dhënie me qira ose emfiteoze të pasurive shtetërore”, pika 1 germa (a) Për ndërtesat; “Jashtë vijave kufizuese të bashkive jo me pake se 100/lekë m² muaj”. Në zonën e dhënë me qira nuk ka dhe nuk ka pasur asnjë ndërtesë dhe linjë, çdo veprim është kryer në zbatim të ligjit minerar nr. 7796, datë 17.2.1994 i ndryshuar dhe lejes së shfrytëzimit minerar nr. 1276 datë 02.12.2008, përkatësisht neni 52 që i jep të drejtë zotëruesit të lejes së shfrytëzimit:

Pretendimi përfundimtar është se diferenca që duhet kërkuar shoqërisë C.....A është në vlerën 832,500 x 7 vite = 5,827,500 lekë dhe jo vlera e rekomanduar nga KLSH prej 423,235,000 lekë.

Bashkia Lezhë nuk ka bërë apelim, pasi vlera e pagesës së tarifës gjyqësore është e lartë prej 4,232,350 lekë (423,235,000 lekë x 1%)

11.1. Rekomandimi: Bashkia Lezhë, të bashkëpunojë me Avokaturën e Shtetit për të ndjekur në rrugë ligjore arkëtimin nga shoqëria C.....A të shumës prej 423,235,000 lekë, rekomandim i KLSH dërguar me shkresën nr. 767/12 prot, datë 03.12.2015 dhe të auditimit lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga ky auditim, dërguar me shkresën nr. 1113/50 prot, datë 25.12.2016, si dhe të detyrimeve shtesë të lindura në periudhën 2016 – 2017, sipas përcaktimeve në “Akt-Marrëveshjen për dhënie për përdorim të truallit pronë e Komunës Balldre”, neni 11-Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE:

C/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 1, datë 09.02.2018 (ish- Komuna Novosel), nr. 13, datë 14.02.2014 (ish- Komuna Shushicë) dhe nr. 14, datë 14.02.2018, nr. 30, 31, 32, 33, 55, 56, datë 27.02.2018 (Bashkia Lezhë), vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c

dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **6 (gjashtë) punonjësve**, si më poshtë:

1. E. H me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të KVO, në 7 (shtatë) procedura.

-“Shërbim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjallëruara në territorin e Bashkisë Lezhë”, zhvilluar më datë 17.07.2016 me fond limit 16,356,742 lekë;

-“Blerje sobash për ngrohje në shkollë”, zhvilluar më datë 07.12.2016 me fond limit 1,666,666 lekë;

-“Rikonstrukcion i shkollës së mesme bashkuar Zejmen”, zhvilluar më datë 19.09.2017 me fond limit 38,203,590 lekë;

-“Grumbullim, transportim i mbetjeve urbane, seleksionim i mbetjeve të ricklushme, depozitim i mbetjeve pariciklushme në landfil në zonën Balldre, Kallmet, Dajç, dhe Ungrej (zona III)”, zhvilluar më datë 29.08.2017 me fond limit 50,563,304 lekë;

-“Grumbullim, transportim, depozitim dhe trajtim i mbetjeve urbane në zonën Shënkoll - Zejmen - Kolsh të Bashkisë Lezhë (zona II)”, zhvilluar më datë 09.01.2017 me fond limit 60,000,000 lekë;

-“Blerjen e dy mjeteve (kamion vetëshkarkues dhe kamion me vinç vetëshkarkues”, zhvilluar më datë 15.08.2017 me fond limit 3,333,333 lekë;

-“Furnizim me artikuj ushqimor për kopshte dhe çerdhe, konvikt viti 2017”, zhvilluar më datë 14.04.2017 me fond limit 8,593,877 lekë.

2. B. M, me funksion Specialiste në Sektorin Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO, në 5 (pesë) procedura.

-“Shërbim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjallëruara në territorin e Bashkisë Lezhë”, zhvilluar më datë 17.07.2016 me fond limit 16,356,742 lekë;

-“Grumbullim, transportim i mbetjeve urbane, seleksionim i mbetjeve të ricklushme, depozitim i mbetjeve pariciklushme në landfil në zonën Balldre, Kallmet, Dajç, dhe Ungrej (zona III)”, zhvilluar më datë 29.08.2017 me fond limit 50,563,304 lekë;

-“Grumbullim, transportim, depozitim dhe trajtim i mbetjeve urbane në zonën Shënkoll - Zejmen - Kolsh të Bashkisë Lezhë (zona II)”, zhvilluar më datë 09.01.2017 me fond limit 60,000,000 lekë;

-“Furnizim me artikuj ushqimor për kopshte dhe çerdhe, konvikt viti 2017”, zhvilluar më datë 14.04.2017 me fond limit 8,593,877 lekë.

Edhe në cilësinë e Kryetarit të NJP, në tenderin me objekt “*Rikonstrukcion i shkollës së mesme bashkuar Zejmen*”, zhvilluar më datë 19.09.2017 me fond limit 38,203,590 lekë;

3. T. M, me funksion Drejtor Ekonomik, në cilësinë e anëtarit të KVO, në 6 (gjashtë) procedura.

-“Shërbim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjallëruara në territorin e Bashkisë Lezhë”, zhvilluar më datë 17.07.2016 me fond limit 16,356,742 lekë;

-“Rikonstrukcion i shkollës së mesme bashkuar Zejmen”, zhvilluar më datë 19.09.2017 me fond limit 38,203,590 lekë;

-“Grumbullim, transportim i mbetjeve urbane, seleksionim i mbetjeve të ricklushme, depozitim i mbetjeve pariciklushme në landfil në zonën Balldre, Kallmet, Dajç, dhe Ungrej (zona III)”, zhvilluar më datë 29.08.2017 me fond limit 50,563,304 lekë;

-“Blerjen e dy mjeteve (kamion vetëshkarkues dhe kamion me vinç vetëshkarkues”, zhvilluar më datë 15.08.2017 me fond limit 3,333,333 lekë;

-“Furnizim me artikuj ushqimor për kopshte dhe çerdhe, konvikt viti 2017”, zhvilluar më datë 14.04.2017 me fond limit 8,593,877 lekë;

-“Blerje sobash për ngrohje në shkolla”, zhvilluar më datë 07.12.2016 me fond limit 1,666,666 lekë.

4. F. D, me funksion Specialiste në Sektorin Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO, në 4 (katër) procedurë.

-“Rikonstruksion i shkollës së mesme bashkuar Zejmen”, zhvilluar më datë 19.09.2017 me fond limit 38,203,590 lekë;

-“Grumbullim, transportim, depozitim dhe trajtim i mbetjeve urbane në zonën Shënkoll - Zejmen - Kolsh të Bashkisë Lezhë (zona II)”, zhvilluar më datë 09.01.2017 me fond limit 60,000,000 lekë;

-“Blerjen e dy mjeteve (kamion vetëshkarkues dhe kamion me vinç vetëshkarkues”, zhvilluar më datë 15.08.2017 me fond limit 3,333,333 lekë;

-“Blerje sobash për ngrohje në shkolla”, zhvilluar më datë 07.12.2016 me fond limit 1,666,666 lekë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në rastet e mësipërme, duke pasur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, është konsideruar mos përmbushje e kërkesave në DST, gjykojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura fituese në vlerën totale të fondit limit 188,093,596 lekë, me efekt financiar në përdorimin e fondeve publike për vlerën 21,933,046 lekë, të llogaritur si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike të operatorëve me mangësi, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriterë të paplota e konkretisht, në kundërshtim me neni 1- “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2- “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24- “Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 53- “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55- “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe neni 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën III/4, faqet 65-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. S. T, me funksion Drejtor i PZHT, dhe

6. N. C, me funksion specialist (inxhinier) në Drejtorinë e PZHT.

Në cilësinë e anëtarit të NJP”, në 1 (një) procedurë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme bashkuar Zejmen”, zhvilluar më datë 19.09.2017 me fond limit 38,203,590 lekë, lidhur kriteret e vendosura nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve, për të cilat është konstatuar se përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokuruar dhe nuk janë të argumentuar me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, konkretisht: -Janë kërkuar kategori licence të kategorisë “C”, të cilat për nga volumi i punimeve nuk e plotësojnë këtë kategori licence (NP-3C, NP-12C, NS-4C); -Nuk argumentohet me punimet sipas preventivit prezenca e 3 (tre) fadromave, 2 (dy) ekskavator dhe një bocat, punë të cilën e bën më një Fadromë dhe peshën kryesore e zënë punimet e ndërtimit dhe jo gërmimi, duke vepruar në papajtueshmëri me nenin 41- “Dokumentet e tenderit”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe Kreut V- “Zhvillimi i procedurës” pika 2- “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të PP”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën III/4, faqet 65-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

C/2. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT)

Nga auditimi i ushtruar nga KLSH, në Bashkinë Lezhë sipas programit të auditimit nr. 249/1, datë 05.03.2018 dhe shtesës nr. 249/2, datë 20.04.2018 për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017, rezulton se nga ana e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Lezhë dhe Njësitë Administrative **Shëngjin dhe Shënkoll** edhe pse janë marë 137 vendime prishje për ndërtime të kundërligjshme nga IMTV Lezhë janë ekzekutuar vetëm 43 vendime prishje, duke mos u zbatuar edhe **94 vendime** prishje për të cilën IMTV Lezhë sqaron se nuk disponon mjete për prishjen e tyre.

Pas fillimit të auditimit të KLSH-së më datën 05.03.2018, IMTV Lezhë me shkresën nr. 2153, datë 13.03.2018 dhe nr. 2768, datë 11.04.2018 ka Informuar dhe kërkuar mbështetje edhe nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes Territorit (IKMT), i cili nuk ka kthyer përgjigje deri më datën 20.04.2018 (*Lista e 137 vendimeve të prishjes pasqyrohen në Aneksin nr.6/2 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi*)

Bazuar në nenin 15 shkronja (c, ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 9/2, pika 1, të ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 dt. 24.02.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i **rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT) që:**

1. Të ushtrojë kontroll në Bashkinë Lezhë dhe Njësitë administrative Shëngjin dhe Shënkoll për 94 ndërtime të kundërligjshme, ndër to edhe ndërtime të përhershme apo të përkohshme, të ngritura mbi shtratin e lumenjve, liqeneve dhe deteve, pavarësisht në se kanë ose jo pikë lidhje me bregun e lumit, liqenit ose detit (neni 9/1 dhe 9/2).
2. Vendosijen e masës (gjobës) si kundërvajtjeve administrative ndaj kryeinspektorit /inspektorëve të Bashkisë Lezhë dhe Njësitë administrative (neni 15) (*Trajtuar më hollësisht në pikën III/6.1, faqet 140-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

D. MASA DISIPLINORE

D/1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (e, ç) e nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë** që bazuar në performancë e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH –së, për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, të fillojnë procedurat për dhënie për **45 punonjësit** e mëposhtëm:

a-“Nga vërejtje me paralajmërim” deri në “Zgjidhjen e kontratës së punës”, për 17 punonjës:

1. M. M, Kryeinspektor i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Bashkia Lezhë filluar punë më datën 31.03.2016 në vazhdim.

Për shkeljet e mëposhtme:

1. Edhe pse nga IMTV Lezhë për 2 vitet 2016-2017 janë nxjerrë 137 vendime prishje për ndërtime të kundërligjshme, nuk janë shoqëruar me Vendime Gjore, (sipas listës të në Aneksin Nr. 6/2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), në kundërshtim me VKM nr. 894, datë 04.11.2015

“Për unifikimin e procedurave të kontrollit territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së territorit dhe i Njësisë Vendore“, pika 2.

Me veprimet apo mos veprimet e tij, Kryeinspektori i IMTV Bashkisë Lezhë ka shkelur ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 dt. 24.02.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, neni 5-Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, respektivisht shkronjat:

b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit.

2- Nuk ka zbatuar plotësisht urdhrin e kryetarit të Bashkisë Lezhë nr. 52, datë 14.04.2017 pika 1 ku përcaktohet se: Të kontrollohet dokumentacioni tekniko-ligjor për të gjitha ndërtimet konstruksionet B/arme, metalik dhe druri, që janë ndërtuar në vijë të parë në rërë në pronë të tyre dhe në hapësira publike nga skeleri tek porti, deri tek kaljera e fundit Kune dhe të mbahen procedurat ligjore për çdo objekt që nuk disponon lejen përkatëse. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet IMTV Bashkia Lezhe, në bashkëpunim me inspektorët e Njësisë Administrative Shëngjin dhe Policia Bashkiake.

3- Edhe pse për vitet 2016-2017 nga Bashkia Lezhë janë dhënë 22 leje ndërtimi (për vitin 2016 janë 15 leje dhe vitin 2017 janë dhënë 7 leje), nga ana e Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkisë Lezhë, nuk janë hapur dosje për secilin subjekt, nuk ka marrë zyrtarisht nga subjektet ndërtuese dokumentacionin teknik-ligjor dhe nuk ka pajisur zbatuesin e punimeve (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1014 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me ligjin nr. 10324, datë 23.09.2010.

2. N. V, me detyrë specialist në Drejtorinë Juridike Bashkia Lezhë, në cilësinë e ish- Drejtor i Drejtorisë Juridike.

Për shkeljen e mëposhtme:

Nga auditimi dosjeve të kontratave për dhënie me qira të hapësirës së plazhit dhe arkëtimin e detyrimeve të kontratave për dhënie në përdorim të hapësirës së plazhit subjekteve private, për periudhën 01.01.2016 deri me datë 31.12.2017, u konstatuan veprime në kundërshtim me kërkesat ligjore, si më poshtë:

-Për vitin 2017, për 14 raste kontratat janë rinovuar pa shlyer detyrimet e vitit 2016 për vlerën 4,637,200 lekë.

- Për të gjitha rastet e lidhjes së kontratave, Drejtoria Juridike nuk ka marrë konfirmimin nga ministria përgjegjëse për turizmin nëse hapësira e plazhit të kërkuar është objekt i ndonjë kërkesë që është duke u shqyrtuar apo një kontrate në kuadër të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", ose është objekt i ndonjë kërkesë apo kontrate për vënien në dispozicion të hapësirës së plazhit për investitorët në zonat me përparësi turizmin,

- Në dosje mungon dokumentacioni tekniko-ligjor si: plani i biznesit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë parashikimin e vlerës së investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve, dokumentacion për të vërtetuar eksperiencë të mëparshme pozitive në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, vërtetim nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

3. I. M me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Aseteve.

4. A. P me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Aseteve.

Për shkeljen e mëposhtme:

-Nga sektori i Menaxhimit të Aseteve për pronat e transferuara Bashkisë Lezhë, me VKM nr. 414, datë 11.7.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Lezhë të Qarkut të Lezhës” dhe pronat transferuara Njësisë Administrative Dajç me VKM nr. 707, datë 12.10.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Dajç të Qarkut të Lezhës”, nuk ka bërë regjistrimin e të gjithë këtyre pronave në ZVRPP, nuk janë inventarizuar, nuk disponohet informacion në lidhje me emrat e personave që i kanë zënë këto prona. Për këto prona nuk janë lidhur kontrata qiraje në referencë të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre asetëve, ndërtesa me sipërfaqe gjithsej 10028 m², për plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e tyre.

5. S. T me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit për periudhën 01.02.2016 e në vazhdim.

Për shkeljen e mëposhtme:

-Për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017, nuk ka marë masa për rakordimin me ALUIZNI-T dhe ZVRPP Lezhë, për pasojë nuk janë arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Lezhë, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 628 persona me vlerë 20,632,717 lekë, në kundërshtim me pikën 5, të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, dhe pikën 3 e nenit 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen*, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar.

-Pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa u mbështetur në asnjë dispozitë ligjore nëpërmjet Bankës ka pranuar derdhjen paradhënie për taksën e ndikimit në infrastrukturë, nga 3 subjekte ndërtuese në shumën 63,000,000 lekë, me mendimin se këtyre subjekteve do tu jepet leja e ndërtimit në vitin 2018, pasi ata janë pronarë të truallit dhe në planin e përgjithshëm urbanistik janë parashikuar në njollat e ndërtimit dhe konkretisht subjektet: sipas listave të vënë në dispozicion

1. Subjekti “J.....K”, fatura për arkëtim nr. 44, datë 04.12.2017 në vlerën 34,000,000 lekë.
2. Subjekti “T.....2”, fatura për arkëtim nr. 46, datë 04.12.2017 në vlerën 25,000,000 lekë.
3. Subjekti fizik “K.....I”, fatura për arkëtim nr. 48, datë 12.12.2017 taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja Banesë kolektive 6 katesh me bodrum në Shëngjin në vlerën 4,000,000 lekë.

Arkëtimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 57, ku parashikohet se: *Këshilli i Ministrave është i vetmi autoritet në nivel qendror që ka të drejtën e marrjes së huave për financimin e projekteve të investimeve nga institucionet ndërkombëtare, shtetet ose personat juridikë, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe me ligjet në fuqi. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore është autoriteti, që ka të drejtën e marrjes së huave dhe dhënien e garancive, brenda dhe jashtë vendit, për huanë vendore.*

6. A. N, me detyrë Drejtor i të Ardhurave Vendore..

Për shkeljet e mëposhtme:

-Drejtorja e Taksave nuk ka bërë rakordim periodik në fund të secilin vit, me mbylljen e bilancit kontabël, dhe të pasqyrohen në Bilancin e vitit në vazhdim, pasi sipas inventarit që u bë nga vetë

punonjësit e Drejtorisë taksave bashkia Lezhë gjendja e debitorëve më datën 31.12.2017 është në vlerën **134,042,129 lekë**, me një diferencë më tepër se kontabiliteti në shumën 74,395,164 lekë, pasi nuk janë ngarkuar debitorët e ish komunave për vlerën prej 44,593,000 lekë.

-Për vitet 2015 dhe 2016 nga Drejtorët, përgjegjësit e zyrës taksave dhe inspektorët e taksave edhe pse janë nxjerrë listat e debitorëve nuk janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë, nuk janë kryer rakordimi ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë taksave, duke mos hapur analizat (partitarët), *në kundërshtim me:*

a. Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6 dhe 7.

b. VKM nr. 783, datë 22.11.2006“Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I, ”Mbajtja e kontabilitetit”, pika 2 shkronja (c),”Dokumentet e kontabilitetit”, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”

c. ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”

d. Udhëzimi i Ministrit Financave nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve pika 3,

Nga veprimet apo mos veprimet e punonjësve të Drejtorisë të ardhurave tatimore më datën 31.12.2017 janë krijuar debitorë në vlerën **134,042,129 lekë**, edhe pse janë nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, **për arkëtimin e tyre nuk janë zbatuar nenet 90, 91 dhe neni 114**, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.164/2014,datë 15.12.2014.

Nuk kanë bërë kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

-Për vitin 2017, për 14 raste kontratat janë rinovuar pa shlyer detyrimet e vitit 2016 për vlerën 4,637,200 lekë.

-Për vitin 2016 dhe 2017, u konstatua se 29 subjekte, për sipërfaqen 18215 m² nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 8,373,000 lekë dhe kamat vonesa të llogaritura në vlerën 546,977 lekë, **gjithsej 8,919,997 lekë**.

- Drejtoria e Taksave, nuk i ka dërguar një listë Drejtorisë Juridike për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në faturën për arkëtim të vitit 2017 bashkëlidhur kontratës nuk janë përfshirë detyrimet e papaguara të vitit 2016, me qëllim mos lidhjen kontratave me subjektet të cilët nuk kanë shlyer këto detyrimi.

7. T. U, Administrator Njësia Administrative Shëngjin.

8. B. N. GJ, specialiste e taksave Njësia Administrative Shëngjin.

9. GJ. GJ, Administrator, Njësia Administrative Ungrej.

10. D. D, specialiste e taksave Njësia Administrative Ungrej.

11. E. N Administrator Njësia Administrative Zejmen.

12. E. F, specialist i taksave Njësia Administrative Zejmen.

13. L. B specialist i taksave Njësia Administrative Zejmen

14. N. Z Administrator Njësia Administrative Kallmet,

15. GJ. GJ specialist i taksave. Njësia Administrative Kallmet

16. GJ. P. L Administrator Njësia Administrative Kolsh.

17. P. L, specialiste e taksave Njësia Administrative Kolsh.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mos krijimin e regjistrit për taksapaguesit familjarë, në kundërshtim me pikën 7, neni 4, të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Për mos njohjen e gjendjes dhe mos marrjen e masave për arkëtimin e taksës së tokës, taksës ndërtesave, tarifës pastrimit etj. bazuar në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 66-*Detyrat e administratës së njësisë administrative*, mbajnë përgjegjësi Administratorët e Njësisë administrative dhe punonjësit e taksave si më poshtë :

b - “Vërejtje me paralajmërim”, për 28 punonjës.

1. **B. P**, me detyrë Inspektor Pyjesh e Kullotash, Bashkia Lezhë.
2. **A. J**, me detyrë Inspektor i Pyjeve dhe Kullotave në NJA Kolsh.
3. **L. L** me detyrë Inspektor i Pyjeve dhe Kullotave në NJA Kolsh.

Për shkeljet e mëposhtme.

-Në menaxhimin e kontratës nr 10676, datë 05.12.2017 pa noter, të shoqërisë “**S.....R**”, me Bashkinë Lezhë për përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Bashkisë Lezhë, prej 2.067 ha, tarifa e qira është llogaritur më pak për shumën 305,415 lekë.

-Për dy kontrata e viteve 2016 dhe 2017, të lidhura nga ish- Komuna Zejmen, nga 2 subjekte për sipërfaqen 1.615 ha, për mos ndjekje të arkëtimin të vlerës së kontratës në vlerën **130,140 lekë**.

Për vitin 2016 dhe 2017, u konstatua se ish –Komuna Kolsh, ka lidhur kontrata pa vlerë me 38 persona për sipërfaqen 86.92 ha, për përmirësimin e fondit pyjorë dhe plotësimin e nevojave vetjake me material drusorë dhe prodhime të tjera, detyrimi i llogaritur sipas VKM nr 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, dhe i papaguar **në vlerën 3,042,480 lekë**.

-Për subjektet të cilat nga MEI kanë marrë leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore nuk ka zbatuar kërkesat ligjore, për heqjen nga fondi pyjorë të sipërfaqeve të dhëna për shfrytëzim e për pasojë mos lidhja e kontratave për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore e kullosore për nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe argjilave nga subjekte **në sipërfaqen 188.67 ha**.

-Për sipërfaqen prej **110.677 ha** fond pyjore dhe kullosor të cilat me VKK Zejmen ka vendosur për dhënien e tyre në përdorim **61 personave** nuk janë lidhur kontrata qiraje me qëllim sigurimin e të ardhurave për Bashkinë.

4. **O. T**, Specialiste për Taksën e Familjes (07.07.2016).
5. **E. P**, Përgjegjëse e Sektorit të Borxhit (03.10.2016).
6. **E. F** Përgjegjëse Shëngjin (filluar me 30.05.2016).
7. **A. GJ**, përgjegjës i sektorit të tereni filluar punë dt. 02.05.2017.
8. **F. S**, Inspektor terreni (filluar 29.04.2016).
9. **E. GJ**, Inspektor terreni (filluar 04.05.2016).
10. **S. R**, Inspektor terreni (filluar me 03.11.2011).
11. **A. E**, inspektor terreni (filluar me 16.05.2016).
12. **SH. L**, inspektor terreni (larguar me 01.10.2016).

Për shkeljet e mëposhtme:

-Drejtorja e Taksave nuk ka bërë rakordim periodik në fund të secilin vit, me mbylljen e bilancit kontabël, dhe të pasqyrohen në Bilancin e vitit në vazhdim, pasi sipas inventarit që u bë nga vetë punonjësit e Drejtorisë taksave bashkia Lezhë gjendja e debitorëve më datën 31.12.2017 është në vlerën

134,042,129 lekë, me një diferencë më tepër se kontabiliteti në shumën 74,395,164 lekë, pasi nuk janë ngarkuar debitorët e ish komunave për vlerën prej 44,593,000 lekë.

-Për vitet 2015 dhe 2016 nga Drejtorët, përgjegjësit e zyrës taksave dhe inspektorët e taksave edhe pse janë nxjerrë listat e debitorëve nuk janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë, nuk janë kryer rakordimi ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë taksave, duke mos hapur analizat (partitarët), *në kundërshtim me:*

a. Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6 dhe 7.

b. VKM nr. 783, datë 22.11.2006“Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I, “Mbajtja e kontabilitetit”, pika 2 shkronja (c),”Dokumentet e kontabilitetit”, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”

c. ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”

d. Udhëzimi i Ministrit Financave nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve pika 3,

Nga veprimet apo mos veprimet e punonjësve të Drejtorisë të ardhurave tatimore më datën 31.12.2017 janë krijuar debitorë në vlerën **134,042,129 lekë**, edhe pse janë nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, **për arkëtimin e tyre nuk janë zbatuar nenet 90, 91 dhe neni 114**, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.164/2014,datë 15.12.2014.

Nuk kanë bërë kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

13. F. Z Inspektor, jurist i IMTV filluar punë më dt. *1.5.2016*

14. A. K Inspektor, Bashkia Lezhë filluar punë më dt. *16.2.2017*

15. A. D Inspektor, Bashkia Lezhë filluar punë më dt. *3.8.2016*

16. G.J. C Inspektor, Bashkia Lezhë filluar punë më dt. *2.5.2017*

17. M. N Inspektor, Bashkia Lezhë filluar punë më dt. *2.5.2017*

18. A. N Inspektor, Bashkia Lezhë filluar punë më dt. *26.5.2017*

19. B. B Inspektor, Bashkia Lezhë filluar punë më dt. *01.11.2016*

20. D. N Inspektor, NJ. Administrative Shëngjin filluar punë më dt.*1.10.2015*

21. B. GJ Inspektor, NJ. Administrative Shëngjin filluar punë më dt.*7.6.2016*

22. Z. GJ Inspektor, NJ. Administrative Shëngjin filluar punë më dt.*1.6.2016*.

23. A. B NJ. Administrative Shëngjin filluar punë më datë *1.10.15*

24. A. Z inspektor NJ. Administrative Shënkoll filluar punë më datë *6.2.2013*.

25. A. K inspektor NJ. Administrative Balldre filluar punë më datë *1.7.2012*

26. R. GJ inspektor NJ. Administrative Blinisht filluar punë më datë *30.09.2016*.

27. M. N inspektor NJ. Administrative Dajç filluar punë më datë *18.4.2017*

28. E. N inspektor NJ. Administrative Kallmet filluar punë më datë *1.10.2015*

Për shkeljet e mëposhtme:

Me veprime apo mos veprime të tyre, Inspektorët e IMTV Bashkia Lezhë kanë shkelur ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 dt. 24.02.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, neni 5-Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore ku përcaktohet se: Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; *(nuk ka vendosur gjoba) edhe 20 gjoba, te vendosura ne arsye te tjera 11 prej tyre janë për mos fillimi punimesh).*

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit.

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

Edhe pse nga IMTV Lezhë për 2 vitet 2016-2017 janë nxjerr 137 vendime prishje nuk janë shoqëruar me Vendime Gjore, në kundërshtim me VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së territorit dhe ai i Njesisë Vendore “, pika 2 .
-Nuk kanë zbatuar plotësisht urdhrin e kryetarit të Bashkisë Lezhë z. F. F nr. 52, datë 14.04.2017 pika 1.

D/2. Për **13 punonjësit** të cilët aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Lezhë, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë që për to të mos propozohet masë. Po ashtu i njëjti qëndrim vlen edhe për punonjësit të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë në marrëdhënie pune me institucionin por që ndaj tyre janë marrë masa nga vet titullari i bashkisë apo janë transferuar në një detyrë tjetër, *respektivisht:*

1. **P. M**, me detyrë ish- Drejtor i Auditit të Brendshëm, aktualisht Drejtor në Drejtorinë e Programimit të Aseteve.
2. **B. GJ**, me detyrë specialist në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.
3. **P. GJ**, me detyrë Specialist Kontabiliteti.
4. **T. M**, me detyrë Drejtor Ekonomik, për arsye të daljes në pension pleqërie.
5. **L. D**, Pergjegjese Sektorit te Regjistrimit dhe Vlerësimit (01.01.2011)
6. **GJ. C**, Përgjegjës Sektori terreni (emëruar 01.06.2016 larguar 01.05.2017)
7. **J. K**, Specialist ne Sek. Borxhit (filluar me 04.05.2018)
8. **M. Z**, Specialist ne Sek. Borxhit (14.03.2008)
9. **E. K**, Përgjegjës i Sektorit te Borxhit deri me (emëruar me 01.5.2016 larguar 3.10.2016)
10. **P. GJ** Administrator Njësia Administrative Dajç
11. **E. G**, specialist i taksave Administrator Njësia Administrative Dajç
12. **S. K**, Administrator, Njësia Administrative Balldre
13. **F. U**, specialist i taksave Njësia Administrative Balldre.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore për sa më sipër, Bashkia Lezhë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

F. Nisur nga fakti që një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit në Drejtorinë e Programim Zhvillimit (Sektori i Menaxhimit të Aseteve) dhe Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, gjatë kohës së auditimit kanë qenë të sekuestruara nga organi i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, procesi i auditimit të pikave VI dhe VII të programit të auditimit nr. 249/1, datë 05.03.2018 të miratuar nga Kryetari i KLSH, nuk ka qenë i plotë, ky auditim për këto pika programi, si dhe pjesërisht për prokurimet (për shkak të ngarkesës që ka patur grupi i auditimit në detyra të tjera në auditime të shumta e rëndësishme dhe situatës në Bashki), do të verifikohet në auditimin e radhës në Bashkinë Lezhë.

G. INDICIE PENAL:

Në zbatim të nenit 15 germa (gj), të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; nenit 248, të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodit Procedurës Penale", i ndryshuar; ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.02.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", neni 5, *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe aktet e tjera bashkëlidhur lidhur, për vlerësim dhe veprime të mëtejshme procedurale, si më poshtë vijon:*

Në auditivin e aktivitet të Inspektorati të Mbrojtjes Territorit Bashkia Lezhë për 2 vitet 2016-2017 janë **nxjerrë 137 vendime prishje**, për ndërtime të kundërligjshme, nuk janë shoqëruar me Vendime Gjobe, (sipas listës të në Aneksin Nr. 6/2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), në kundërshtim me VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së territorit dhe ai i Njësisë Vendore", pika 2 ku përcaktohet se: Kryeinspektori/inspektori i njësisë vendore, gjatë kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, i vlerëson shkelje të punimeve në ndërtim rastet e mospërputhjes së objektit në ndërtim me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik të zbatimit apo me deklarinimin paraprak të miratuar e të konfirmuar nga organi i autorizuar, si: **a) ndërtimi i volumeve të tepërta në lartësi ose në gjerësi të objektit (shtesë kati ose shtesë anësore);**

Me veprimet apo mos veprimet e tij, Kryeinspektori i IMTV Bashkia Lezhë ka shkelur ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 dt. 24.02.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", neni 5-Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore ku përcaktohet se: Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R